



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.553/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi, dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Milija Manojloviq nga Fshati Gorazdevac, Komuna e Pejës, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e Milija Manojloviq nga Fshati Gorazdevac, Komuna e Pejës, me shenjë ZL.Anr.553/2017 e datës 30.10.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 30.10.2017, ka pranuar një ankesë nga Milija Manojloviq nga Fshati Gorazdevac, Komuna e Pejës të dërguar nëpërmjet postës më datë 24.10.2017, me të cilën ka pretenduar se në Vendvotimin 1715C/02D në Shkollën Filllore “Janko Jovicevic” në Gorazdevac nuk iu është lejuar të votoj pa ndonjë arsye, me të cilën është diçka e parregullt. Mëtej ka theksuar se dora e tij e djathtë nuk ka fare gjurmët e sprejit, ndërsa në dorën e majtë e ka vetëm një pikë. Parashtruesi i ankesës thekson se punon në Patriarkat dhe nga puna ka shkuar të votoj.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është dorëzuar në postë, nga parashtruesi i ankesës me datë 24.06.2017, ndërsa në PZAP e njëjta është pranuar më datën 30.10.2017. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruar nga ankuesi në ankesë ZL.Anr.553/2017 të datës 30.10.2017, ndërlihet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar me postë, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka dorëzuar në postë më datë 24.10.2017 dhe është pranuar nga PZAP-i më datë 30.10.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.553/2017 më datën 31.10.2017



Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala

***Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*